



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 46

Prishtinë, më 08.02. 2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, kryetar, Ganimete Musliu, nënkryetare e parë, Rexhep Selimi, Qerim Bajrami, Fatmir Shurdhaj, Nuredin Ibishi dhe Zafir Berisha, anëtarë.

Munguan: Bojan Mitiq dhe Anton Quni.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati-Zyra e Presidentit të Kosovës; Blend Zyrapi dhe Gent Gjokolli-KIPRED; Dhurata Kryeziu-OSBE dhe Genc Jaha-KDI.

Nga Staf i mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Kryesuesi i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më 17.01.2017 dhe 24.01.2017;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më 17.01.2017 dhe 24.01.2017

Procesverbalet, e mbajtura më 17.01.2017 dhe 24.01.2017, u miratuan me vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive.

Kryetari, fjalën ia kaloi z. Rexhep Selimi, kryesues i grupit punues, për këtë projektligj për të paraqitur amendamentet e grupit punues.

Rexhep Selimi, fillimisht theksoi që ky projektligj është produkt i ligjit bazik, e që është ligji për armë. Grupi punues ka nxjerrë shtatëmbëdhjetë amendamente, disa nga amendamente janë edhe teknike, por që kanë qenë të nevojshme. Më tutje kërkoi përkrahjen e Komisionit për amendamentet e propozuara të cilat më pas do të procedohen edhe në seancë. Amendamentim esencial e konsideroi që është bërë ndryshimi i emrit të projektligjit i cili është riformuluar Projektligji nr.05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive. Më tutje konsideroi që miratimi i këtij projektligji do t'i kontribuonte procesit të dorëzimit të armëve duke shpresuar në votimin unanimit në seancë për amendamentet e propozuara.

Fatmir Shurdhaj, duke iu referuar nenit të pestë të projektligjit, që i referohet legalizimit të armëve, theksoi që kemi të bëjmë me diçka që nuk është cekur dhe se Kodi Penale sanksionon heqjen apo ndryshimit të kundërligjshëm të shenjave në armë të zjarrit dhe të municioneve. Ndërsa kur jemi te armët të cilat duhet të dorëzohen te personat juridikë, dhe personi fizik që e dërgon te personi juridik nuk e dinë nëse arma e tij ka pësuar ndonjë ndryshim në numër apo në ndonjë shenjë, dhe në këtë rast kemi të bëjmë me një procedurë, ku legalizohen armët që kanë ardhur përmes rrugëve të kontrabandës të përdorura për qëllime kriminale dhe personat e tjerë mund të pësojnë nëse legalizohen këto armë, prandaj propozoi që do të ishte mirë që edhe kjo çështje të sanksionohet me ligj, pasi nëse ndryshohet arma nga pjesa origjinale, të jetë kontestuese nga Komisioni i cili bënë legalizimin e armëve.

Zafir Berisha, kërkoi sqarim lidhur me termin armë trofe që përmendet në ligjin bazik për armë dhe armë historike në projektligjin për legalizim të armëve. Gjithashtu kërkoi sqarim tek akronimi Armë të Vogla dhe të Lehta.

Rexhep Selimi, në përgjigjeje të pyetjeve të Zafir Berisha, theksoi që sa i përket akronimit armë të vogla dhe të lehta, pas analizimit është parë që nuk është e nevojshme të jetë në tekstin e projektligjit, përderisa trajtohet në ligjin bazik. Ndërsa sa i përket çështjes së armëve trofe, theksoi se kjo çështje është e rregulluar me ligjin bazik dhe me ligjin për forenzik, dhe kushti i legalizimit të tyre është pas çaktivizimit të tyre.

Kryetari, theksoi se qëllimi i këtij ligji është fisnik për të përcaktua një politik të caktuar dhe për krijimin e kushteve dhe procedurave për legalizimin armëve.

Nurdin Ibishi, shprehi një shqetësim sa i përket kostos e cila do të jetë për legalizimin e armëve për personat që do t'i dorëzojnë, për këtë arsye propozoi që në ligjin primar të përcaktohet kostoja pasi kjo mund të krijojë efekt negativ në procesin e dorëzimit, pasi është e pa qartë se kush do të mbulojë shpenzimet e personi që dorëzon apo organi që bënë pranimin dhe procedimin.

Rexhep Selimi, për çështjen e ngritur nga Nuredin Ibishi, theksoi që kjo çështje i mbetet politikave të qeverisë dhe nuk mund të përfshihet në strukturë të projektligjit.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së në këtë pikë të rendit të ditës mori këtë

PËRFUNDIM

Miratohen amendamenteve e propozuara për Projektligjin Projektligjit nr.05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive dhe të njëjtat sipas procedurës i përcillen komisioneve të përhershme të Kuvendit për opinion.

Kryetari, fjalën ia kaloi Ganimete Musliu, për të njoftuar lidhur me vizitën e realizuar në Inspektoratin Policor të Kosovës, në kuadër të mbikëqyrjes së rekomandimeve për Ligin e IPK-së.

Ganimete Musliu, theksoi që në kuadër të mbikëqyrjes së Ligjit të IPK-së është realizuar vizita në Inspektoratin Policor të Kosovës dhe e shoqëruar ka qenë nga Nuredin Ibishi. Kryeshefi është njoftuar që do të jetë i ftuar edhe në Komision për të raportuar. Gjatë këtij takimi janë identifikuar një sërë çështjesh të cilat janë pengesë për punë e përditshme, ku u veçua çështja e sistematizimit të pagave, objekti ku ndodhet IPK-ja, për këtë arsye propozoi që pasi të ftohet në Komision kryeshefit i IPK-së të diskutohen edhe të gjitha çështjet që kanë dalë nga takimi.

Nuredin Ibishi, lidhur me vizitën e realizuar në IPK, theksoi që janë mbikëqyrur rekomandimet e dhënë në vitin 2013 dhe mbështet idenë që pasi të jetë i ftuar në Komision kryeshefi të shpërfaqën të gjitha çështjet që kanë dalë nga takimi.

Kryetari i njoftoi që gjatë këtij muaji sipas agjendës së punës do të organizohet një tryezë e përbashkët me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe policinë e Kosovës rreth zbatimit të Ligjit të Policisë së Kosovës dhe në të njëjtën kohë të jetë ftuar edhe Inspektorati policor i Kosovës, gjithashtu do të diskutohet rreth shpenzimeve financiare për institucionet sigurisë.

Nuredin Ibishi propozoi që para se të vije në shqyrtim Projektligji për nivelizimin e pagave, Komisioni të realizojë një takime të gjitha institucionet e sigurisë që ka në fushëveprim për të parë se si janë trajtuar dhe të jemi në kohë para miratimit të ligjit.

Kryetari propozoi që në takimin radhës i ftuar në Komision për raportim të jetë Hilmi Mehmeti, kryeshefi i Inspektoratit Policor të Kosovës.

4. Të ndryshme.

Kryetari njoftoi që me kërkesën e Anton Quni, anëtar i Komisionit, është propozuar që të ftohet në raportim Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Shpend Maxhuni, rreth disa lëvizjeve të disa pjesëtarëve të uniformuar në veri të Kosovës, pamje të transmetuara edhe në media. U propozua që më 13 shkurt të ftohet në raportim drejtori i Përgjithshëm i Policës.

Më tutje njoftoi për debatin e iniciuar lidhur me transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura, debat i cili do të zhvillohet në seancën e nesërme. Iniciativa ka qenë e kryetarit, pro me që ka pasur hezitime për të dhënë nënshkrimin është shkuar me procedurën duke marrë nënshkrimet e deputetëve nënshkrues. Qëllimi i këtij debati nuk ka qenë për të tronditur opinionin, por ka qenë urgjencë për t'i dhënë zgjidhje kësaj çështje, përderisa Qeveria nuk ka dhënë zgjidhje deri tani për formimin ushtrisë. Më tutje ftoi që nesër të gjithë anëtarët e Komisionit të japin kontributin në debat dhe në përfundim të dilet me rekomandime për Qeverinë dhe Ministrinë e FSK-së që të përgatisin hapat e më tutjeshëm. Qëllimi është krijimi i një ushtrie për të gjithë qytetarët e Kosovës ku të përfshihen të gjitha komunitete që jetojnë në Kosovës.

Rexhep Selimi theksoi që Komisioni në shumicën e çështjeve ka reaguar për unitet, dhe uniteti është shprehur në takimin paraprak me prezencën e Ministrit të FSK-së dhe Komandantit të FSK-së, për të iniciuar një debat. Më tutje theksoi që është i befashuar në aspektin formal për mungesën e nënshkrimeve nga disa anëtarë të Komisionit në kërkesën e kryetarit për debat. Më tutje vlerësoi që kjo iniciativë është e Komisionit dhe në seancën e radhës të kemi qëndrimin e njëjtë.

Zafir Berisha theksoi që nisma për debat është e qëlluar, ndërsa mungesën e disa nënshkrimeve e konsideroi më shumë si objektive për shkak të vizitave të rëndësishme jashtë vendit, ndërsa nga debati kërkoi që të dilet me një ide, që Komisioni të kërkojë në mënyrë formale që pas seancës çështja e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të bëhet me hapa konkret, duke shkuar me planin B.

Ganimete Musliu theksoi që për shkak të ndjeshmërisë së çështjes dhe domosdoshmërisë së çështjes së transformimit të FSK-së, nuk ka dhënë opinione në media, por që është ndier e dëshpëruar pas leximit të deklaratave të anëtarëve të Komisionit, kur thuhet që anëtarët nga pozita janë kundër debatit. Më tutje theksoi që ka qenë e pa kuptimtë kur është kontaktuar nga

asistentja e grupit parlamentar të AAK-së, për të nënshkruar nismën e ndërmarrë nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, ndërkohë si nënkryetare nuk ka qenë e informuar. Në takimin paraprak është diskutuar mundësia për debat, por që nuk është marrë vendi për debat parlamentar në emër të Komisionit. Sa i përket asaj se kush është për dhe kundër transformimit, rekomandoi të shikohet debati para tre vjetëve në Kuvendin e Kosovës, duke shtuar që Partia Demokratike e Kosovës, nuk ka qenë asnjëherë kundër transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura dhe se atribuimet se kush e mbështet ose jo nuk i shërbejnë për të mirë as Kosovës dhe as Forcave të Armatosura në të ardhmen.

Kryetari theksoi që Qeveria ka mandat të kryej detyrën dhe të kontribuojë, ndërsa sa i përket asaj që është diskutuar për të bërë një debat, theksoi që kjo ka rrjedhur nga takimi i fundit me Ministrin e FSK-së, por edhe nga takimet e mëhershme, gjithashtu njoftoi që ka pasur takime të shumta me udhëheqësit vendor, Kryeministrin, ministrin, si dhe Komandantin e FSK-së. Më tutje theksoi që duhet të thuhet drejt që u është bërë presion për të tërheq nënshkrimet dhe se ka telefonuar ministri i FSK-së, ku ka kërkuar që të shtyhet debati për më vonë, gjithashtu përmendi edhe zhvillimet e rajonit.

Qerim Bajrami theksoi që edhe pse nuk ka qenë i pranishëm në takimin paraprak me ministrin, por në momentin që i është kërkuar nënshkrimi i kërkesës së iniciuar nga kryetari i Komisionit e ka nënshkruar, pasi konsideroi që ky proces është vonuar, për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura. Gjithashtu kërkoi që nesër të prezantohet kjo si iniciativë e Komisionit dhe të ketë unitet për këtë çështje dhe në fund të dilet me rekomandimet konkrete për Qeverinë dhe të jemi në koordinim me bashkësinë ndërkombëtare dhe NATO-n, duke e konsideruar si më i mundshëm versioni i ndryshimit të misionit përmes ligjit. Më tutje kërkoi që kur përmendet mbështetja për transformimi i FSK-së, të theksohet që komunitete e tjera mbështesin këtë proces për dallim nga komuniteti serb dhe se mbështetja e tyre do të jetë gjithmonë.

Nuredin Ibishi, lidhur me kërkesën për debat dhe mosnënshtrimin e saj, theksoi që nuk është marrë vendim formal në Komision për të thirrur një debat dhe vlerësoi që ende nuk janë pjekur kushtet për një debat publik, pasi ende nuk është bërë një interpretim i Kushtetutës për të parë nëse është kjo mundësi, si dhe aspektet e tjera që kanë të bëjnë me prezencën ndërkombëtare civile dhe ushtarake. Për këtë arsye vlerësoi që në çështje të tilla të bëhet kujdes dhe konsideroi që transformimi i FSK-së në Forca të Armatosura është interes i përgjithshëm.

Fatmir Shurdhaj theksoi që ka pranuar njoftimin nga Grupi Parlamentar i AAK-së për të nënshkruar kërkesën për debat, por që nuk ka qenë në Kosovë. Nga takimi me ministrin e FSK-së dhe Komandantin e FSK-së është dakorduar që të shtjerrën të gjitha mundësit e brendshme në Komision me qëllim për të mos e dëmtuar procesin, dhe konsideroi që nuk është bërë debat i mirëfilltë dhe nuk është debatuar me të gjitha komunitete, për të bindur që FSK-ja në të ardhmen do të jetë e të gjithë qytetarëve. Më tutje vlerësoi që nuk është mirë që përmes flamujve partiakë të tentohet në krijimin e ushtrisë, dhe vlerësoi që debati është i mirë, por aktualisht nuk janë rrethanat dhe për më tepër negativja është që deklarimi i disa anëtarëve që nuk japin nënshkrimet. Gjithashtu shtoi se nuk duhet të humbur momenti që FSK-ja të jetë ushtri e shtetit dhe të mbrojë sovranitetin territorial të shtetit.

Kryetari theksoi që është Kuvendi vendi ku do të bëhet debati, është rregullorja e Kuvendit që mundëson organizimin dhe thirrjen e një debati dhe kjo çështje nuk ka logjik të “bajraktarizmit” dhe në cilësinë e kryetarit të Komisionit e ka këtë të drejtë. Ndërsa nëse ka vërejtje sa i përket procedurës se iniciuar mund të ketë vërejtje, por në kërkesë nuk është përmendur emri i AAK-së. Më tutje theksoi që është bërë një punë e madhe duke filluar nga analiza e rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë, përgatitja e dokumenteve të tjera që ku kanë kontribuar edhe ekipet këshilluese të NATO-s në Kosovë, janë bërë planifikime buxhetore në rast të transformimit, prandaj konsideroi që nuk duhet parë si e njëanshme iniciativa për debat pasi qëllimi është fisnik.

Fatmir Shurdhaj theksoi që nga ana e Komisionit nuk është marrë vendim i prerë për debat dhe se debati paraprak është i nevojshëm dhe konsideroi se do të duhej të bisedohej me përfaqësuesit e listës serbe si Komision, si dhe diskutimi dhe shterja e debatit me faktorin ndërkombëtar, pasi FSK-ja ka kosto buxhetore dhe kjo çështje është me interes shtetëror.

Rexhep Selimi konsideroi që është në rregull të bëhet debat paraprak, por në Kuvend është vendi adekuat për një debat të tillë dhe shtoi se ka qenë i befasuar për mos unitet pasi edhe pse nuk ka pasur vendim ka qenë një dakordim dhe propozimi për debat ka qenë i mirëpritur nga ministri i FSK-së dhe Komandanti i FSK-së. Më tutje theksoi se nisma është e deputetëve nënshkrues dhe janë respektuar procedurat për thirrjen e debatit parlamentar.

Ganimete Musliu, duke iu referuar fjalës së z. Selimi dhe kryetarit të Komisionit, theksoi që duket që ajo çfarë thuhet dhe praktika nuk përputhen, pasi përderisa bëhet thirrje për unitet duhet të ketë edhe veprime të tilla. Ndërsa sa i përket procedurës me anë të së cilës është proceduar kërkesa për debat, theksoi që kjo duhet të bëhet përmes zyrës koordinuese të stafit mbështetës të Komisionit, pasi nuk e pranon nënshkrimin e dokumenteve nga asistentë e asnjërit grup parlamentar, për vendimet e dala nga Komisioni, pasi asnjëherë nuk është kundërshtuar debati për FSK-n, pasi Komisioni gjithëherë ka pasur konsensus dhe është për keqardhje që nuk janë të gjitha nënshkrimet për shkak të procedurës jo të rregullt përmes së cilës është proceduar kërkesa edhe pse asnjëherë nuk kanë qenë kundër, ndërsa sa i përket mbështetjes ose jo të këtij debati, në ditën kur do të jetë debati Partia Demokratike e Kosovës do të tregojë qëndrimin e saj, pasi gjithëherë e ka mbështetur këtë gjë.

Qerim Bajrami ftoi të gjithë anëtarët që në ditën kur do të jetë debati të jenë seriozë, pasi pas transformimit të FSK-së do të dalin shumë obligime dhe propozoi që në fund të takimit të votohet propozimi që Komisioni mbështet debatin për FSK-së që do të mbahet në Kuvend.

Rexhep Selimi theksoi që sa i përket procedurës konsideroi që nëse është për çështje objektive, kjo nuk është problematike, ndërsa sa i përket shterjes së debatit, theksoi që nuk duhet pritur që të diskutohet me Listën Serbe, përderisa dihet qëndrimi i tyre.

Zafir Berisha theksoi se nuk pajtohet me qëndrimin e disa anëtarëve të Komisionit, duke shtuar që është PDK-ja ajo që nuk ka çuar përpara procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura, pasi kjo nuk është logjik e bërjes së shtetit.

Nuredin Ibishi theksoi që misioni i FSK-së dhe organogrami i FSK-së nuk janë kategori Kushtetuese, ndërsa sa i përket mundësisë së dërgimit pas miratimit të këtij ligji në kushtetuese

nuk është pranuar ndonjë raport, për këtë arsye kërkoi që edhe për këtë çështje të ketë interpretim.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, pas diskutimeve, me propozimin e anëtarit të Komisionit Qerim Bajrami me vota unanime nxori këtë

PËRFUNDIM

Komisioni, me të gjithë anëtarët e tij prezent në këtë takim, do të jenë unik në debatin që do të zhvillohet në kuvend, lidhur me transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forcave të Armatosura të Kosovës.

Kryetari me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj